

Informacion për aktivitetet e zhvilluar në kuadër të “Muajit të hapur në KLSH ” për periudhën 19-23 nëntor 2018

KLSH promovon librin “Përjetësia e dyfishtë” të autorit Bedri Islami

Në datën 19 nëntor në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në sallën “Lech Kaczynski”, u promovua libri “Përjetësia e dyfishtë”, me autor Bedri Islamin, që i kushtohet dy heronjve të luftës së Kosovës, Fehmi Lladrovci dhe Xheva Krasniqi-Lladrovci.

Në këtë aktivitet morën pjesë përveç autorit dhe audituesve të KLSH-së, i ngarkuari me punë i Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, z.Syl Ukshini, Kryetari i Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci, z.Namik Dokle, z.Dilaver Goxhaj, z.Ismet Sulejmani, poeti Xhevahir Spahiu, shkrimtari Sulejman Mato, z.Ago Nezha, aktorët Bujar Asqeriu e Mirush Kabashi, etj.



Materialin e plotë për këtë aktivitet e gjeni në linkun :

http://www.klsh.org.al/web/KLSH_promovon_librin_Perjetesia_e_dyfishte_te_autorit_Bedri_Islami_3637_1-1.php

Rezultatet dhe rekomandimet e auditimit të Performancës "Urgjenca Kombëtare Mjekësore"

Në datën 20 nëntor në kuadër të Muajit të Hapur, KLSH në bashkëpunim me USAID-in zhvilluan aktivitetin, rezultatet dhe rekomandimet e auditimit të Performancës "Urgjenca Kombëtare Mjekësore" pjesë e Projektit “Transparenca në Sistemin Shëndetësor”.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të OJF të ndryshme, auditues të performancës dhe kolegë të tjerë të KLSH-së, të interesuar mbi ecurinë e përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Fjala e hapjes së këtij takimi u mbajt nga Prof. Dr. Lindita Lati Milo, Drejtore e Përgjithshme në KLSH. Gjatë fjalës së saj zonja Lati theksoi se :

Diskutimet e kësaj tryeze pasqyrojnë instrumentet që po përdor KLSH në zbatim të strategjisë së komunikimit për të forcuar bashkëpunimin real me partneret tanë dhe në mënyrë të veçantë roli dhe rëndësia e shoqërisë civile qëndron në faktin që përbën zërin e gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH. Pritshmëria reale e projektit është jo thjesht outputet e realizuara për një bashkëpunim në rritje pasi tashmë ju kuptoni më mirë mënyrën se si punon dhe gjeneron rekomandimet KLSH.

Rezultatet dhe rekomandimet e këtij auditimi u prezantuan nga znj. Erieta Këlliçi, audituese pranë këtij Departamenti.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka publikuar raportin përfundimtar për Urgjencën Mjekësore, ku konstaton se ky shërbim ka problematika të përsëritura në shërbimin e urgjencës, të cilat evidentojnë qartësisht një mungesë lidërsipi, koordinimi, bashkëpunimi dhe transparence midis institucioneve shtetërore.



Në analizën e riskut, KLSH thekson se ka pasur shkurtim të fondeve për shëndetësinë për vitet 2015-2016; Shërbimi nuk është i shtrirë në gjithë territorin; ka një numër të pamjaftueshëm ambulancash dhe mjetesh. Po ashtu nuk janë miratuar standardet për pajisjet mjekësore, barnat, infrastrukturën fizike, autoambulancat dhe mjetet e tjera.

KLSH konkludon se veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e urgjencës mjekësore në vendin tonë për periudhën objekt auditimi i ka munguar efektiviteti në disa aspekte kyçe të saj.

Që nga momenti i krijimit, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), pavarësisht përpjekjeve, nuk ka vepruar në mënyrë efektive me qëllim identifikimin e prioriteteve kyçe sa i takon planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem mbarë-shtetëror të unifikuar, duke arritur të ofrojë vetëm koordinim të pjesshëm për qytetin e Tiranës. QKUM nuk ka kryer rishikim të cilësisë së shërbimit të urgjencës në shkallë vendi dhe nuk ka ushtruar kontroll të brendshëm në të gjithë shërbimin e urgjencës mjekësore, duke penalizuar zhvillimin e këtij shërbimi, si edhe aktivitetin e vet në këtë drejtim. Ky institucion nuk ka qenë i aftë të ndërtojë një kanal komunikimi zyrtar me MSHMS, me qëllim përcjelljen e të gjitha problematikave të ndeshura në shtrirjen e shërbimit në shkallë vendi dhe në mbarëvajtjen e tij. Mosveprimi dhe neglizhenca e treguar shpreh qartë që ky institucion nuk ka gjeneruar impaktin e përcaktuar nga Ligji për përmirësimin e shërbimit të urgjencës mjekësore.

Sipas KLSH, mungesa e vendosjes së standardeve nga MSHMS për barnat, pajisjet mjekësore në të gjitha nivelet e shërbimit të urgjencës në vendin tonë, sipas përcaktimeve ligjore nuk ka lejuar një zhvillim bashkëkohor të sistemit të urgjencës mjekësore, duke mos arritur të plotësojë pritshmëritë e taksapaguesve mbi këtë shërbim.

Prezantimi nga Instituti Shqiptar i Shkencës mbi *Data Mining* dhe Mekanizmin e ankesave

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe USAID, për projektin “Transparenca në Sistemin Shëndetësor”, në datën 21 nëntor , në ambientet e KLSH-së u realizua prezantimi i dy produkteve të rëndësishme të këtij projekti, nga zj.Viola Civici dhe konkretisht:

Mekanizmi i Ankesave

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm **letrat dhe ankesat e qytetarëve**, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit. Megjithatë, edhe në këto raste KLSH i ka orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.

Duke marrë në konsideratë numrin e lartë të ankesave drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, jo vetëm me postë zyrtare por edhe nëpërmjet website-t zyrtar, në kuadër të projektit, është dakordësuar zhvillimi i mekanizmit të ankesave. Ky mekanizëm do të pranojë ankesa nga qytetarët, me kusht që ata të plotësojnë të gjitha fushat e informacionit. Në këtë mënyrë shmangen ankesat anonime, të cilat mund të jenë pa përmbajtje ose mund të përmbajnë supozime të përgjithshme, të pabaza për t’u shqyrtuar më tej.



Ky mekanizëm është implementuar dhe testuar në faqen zyrtare të KLSH-së.

Ne mendojmë-përfundoi zj.Civici-që ky mjet do ta ndihmojë KLSH-në dhe qytetarin të jenë më transparentë në këtë proces. Qytetari mund të marrë informacion në website mbi statusin e ankesës së tij, nëse ajo është nën shqyrtim, është jashtë kompetencës së institucionit apo është zgjidhur.

Instrumenti Data Mining

Transparenca e aktivitetit të KLSH-së është një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe të komunikimit të tij shumë dimensional. Qasjen e komunikimit të pandërprerë me qytetaret, KLSH e ka parë në këto vite, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe me media-n, si dhe nëpërmjet përgjigjeve ndaj letrave të qytetarëve. Instrumenti Data Mining mundëson nxjerrjen e të dhënave të ndryshme nga baza të dhënash të jashtme. Ne jemi gjithmonë në media me artikuj të punuar nga vet audituesit tanë, raporte

auditimi, artikuj në gazeta apo portale të ndryshme. Ky proces mundëson nxjerrjen e të dhënave të ndryshme nga mediat online:

- Artikuj të përgatitur nga stafi i KLSH;
- Artikuj që citojnë gjetje të auditimeve të KLSH-së, që përmbajnë fjalë kyçe në fokus të KLSH si ekonomikitet, dëm ekonomik, auditim, eficiencë, të ardhura të munguara, përmirësime ligjore, etj.

Ky instrument është vendosur në website-n e KLSH-së dhe do të aksesohet për një afat të papërcaktuar, pavarësisht së çfarë zgjedhin të bëjnë mediat online me artikujt origjinalë.

Nga auditueist e pranishëm kishte shumë diskutime, veçanërisht për mekanizmin e ankesave të qytetarëve.

Vizitë e audituesve të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA) në KLSH

Në datat 22 dhe 23 nëntor, një grup prej 8 audituesish nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës kryen një vizitë studimore në KLSH:

- Zj.Shpresa Zenelaj, Audituese, Departamenti për Auditimin e Ndërmarrjeve Publike;
- Zj.Sabile Muli, Audituese, Departamenti për Auditimin e Institucioneve Qendrore;
- Zj.Vlora Duraku, Audituese, Departamenti për Auditimet e Performancës;
- Zj.Luljeta Morina, Audituese, Departamenti për Auditimin e Komunave;
- Zj.Selvet Foniqi, Audituese, Departamenti për Auditimin e Institucioneve të Pavarura;
- Zj.Violeta Smajlaj, Audituese, Departamenti për Çështje Ligjore në Auditim;
- Z.Imer Vitija, Auditues, Departamenti i Metodologjisë dhe Kontrollit të Cilësisë; dhe
- Z.Gazmend Namani, punonjës i Administratës.

Takimin e hapi zj.Irena Islami, Drejtore e Komunikimit dhe e Marrëdhënieve me Jashtë në KLSH, e cila pasi u uroi mirëseardhjen audituesve nga Kosova, vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin mes ZKA dhe KLSH-së, veçanërisht në shkëmbimin e eksperiencave pozitive të punës, trajnimeve, workshopeve, auditimeve paralele, etj.



Më pas e mori fjalën zj. Albana Gjinopulli, Drejtore e Departamentit të Metodologjisë së Auditimit, e cila bëri një prezantim të detajuar të metodologjisë së Auditimit në KLSH.

KLSH kryen auditimet e tij në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, ISSAI, të zbatuara në kontekstin specifik shqiptar. Këto standarde ndihmojnë në sigurimin e cilësisë dhe profesionalizmit të punës së KLSH-së, si dhe efikasitetin e tij.



Një kuadër metodologjik i plotë dhe i avancuar merr jo vetëm një rol të rëndësishëm në cilësinë e auditimit, por gjithashtu ndikon në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe nga subjektet e audituara, kontribuon në rritjen e rolit parandalues të shkeljeve financiare dhe mashtrimeve. Kjo do të krijojë vlerë të shtuar për KLSH, duke krijuar besim më të madh tek KLSH, e cila bazohet në standardet profesionale të njohura ndërkombëtarisht, të udhëhequr nga parimet e pavarësisë, etikës, profesionalizmit, transparencës dhe shërbimit në interes të publikut.

Në nivelin metodologjik, KLSH ka përqendruar përpjekjet e saj në forcimin e zhvillimit institucional përmes harmonizimit të manualeve, rregulloreve dhe udhëzimeve me standardet e INTOSAI-t, ISSAI dhe standardeve të tjera profesionale. Harmonizimi nënkupton përmirësimin e bazës kombëtare dhe institucionale të metodologjisë së auditimit për ta bërë atë të përshtatshme dhe lehtësisht të përdorur për nevojat e audituesve për të siguruar auditime efektive.

Takimi vijoi me prezantimet e mëposhtme :

- z.Kozma Kondakçiu, Drejtor i Drejtorisë së auditimit IT, mbi Manualin e Auditimit IT;
- z.Qeram Cibaku, Përgjegjës Sektori në Departamentin e Metodologjisë së Auditimit, mbi Udhëzuesin për zbulimin e korrupsionit dhe mashtrimin financiar në Auditim;
- zj.Yllka Pulashi, Drejtor i Departamentit të Shoqërive Publike dhe investimeve të Huaja, mbi Auditimet e ushtruara në shoqëritë publike;
- zj.Aulona Jonuzi, kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Aktivitetin e mbylli zj.Gjinopulli, e cila u përqendrua në rëndësinë që i është dhënë zhvillimit profesional në KLSH në vitet 2012-2018.

Kongresi XXII i INCOSAI-t e përcaktoi profesionalizimin si proces i vazhdueshëm i fitimit me autoritet të cilësisë dhe statusit të ekspertit dhe të etikës, duke demonstruar një nivel të lartë të kompetencës ose aftësisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka përkthyer këtë në detyrë që kërkon më shumë angazhim të audituesit publik, duke e konsideruar veten si profesionist, duke bërë punën e duhur në kohën e duhur, me sa më efektivitet dhe efikasitet që të jetë e mundur. Motoja e Kongresit të X-të të EUROSAT-t në Stamboll, e cila ishte **“Zbatimi i ISSAI-ve: Sfidë dhe zgjidhje për zhvillim të mëtejshëm”** përbën thelbin e Programit të Zhvillimit Profesional, duke u kthyer në temën bazë mbi të cilën do të zhvillohen më pas veprimtaritë për zhvillim profesional.

Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018 -2022 konfirmoi vazhdimësinë e politikave mbështetëse dhe nxitëse që KLSH ka aplikuar dhe aplikon që prej vitit 2012 në drejtim të investimit në ndërtimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të kapaciteteve audituese dhe institucionale. Përbushja e rolit dhe misionit të KLSH është parë në një horizont afatgjatë dhe me shtrirje të plotë në veprimtarinë audituese, duke sjellë në qendër të vëmendjes zhvillimin profesional.

Në përfundim të aktivitetit, grupi i audituesve nga Kosova zhvilloi një takim me Kryetarin e KLSH-së, z.Bujar Leskaj lidhur me bashkëpunimin mes dy SAI-ve.

